

PKR.nr. 699/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit Q. Q. nga fshati T., Komuna G., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.61/14, të datës 09.12.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 16.11.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri dhe të pandehurit Q. Q., po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Q. Q., i biri i H. dhe nënës E., e vajzërisë R., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin T., Komuna G., ku edhe tani jeton, i martuar babë i gjashtë fëmijëve, ka të kryer gjashtë vjet të shkollës fillore, punëtorë fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS, me numër personal *numër personal...*,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 12.01.2014 rreth orës 12:25 në shtëpinë e tij në fshatin T. KK-G., pa autorizim ka mbajtur armë, në atë mënyrë që bashkëshortja e tij, M. Q., fillimisht ka lajmëruar Pjesëtarët e PK-së se bashkëshorti i saj tani i pandehuri Q. mbanë armë në shtëpinë dhe në momentin kur pjesëtarët e PK-së shkojnë tek shtëpia e të pandehurit, ajo ua dorëzon armën e tipit “Zastava” me nr.serik ET-890485 me një karikator,-

- me këtë ka kryer veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248, 365, 366 të KPP, i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** muaj i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **1 (një) viti** nuk do të kryejë vepër të re penale, si dhe

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: një armë Pistoletë “Zastava” me numër serik ET-890485 dhe një karikator, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve, Nr.2014-AG-0028, të datës 12.01.2014, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të Rënda, me Aktakuzën PP.nr.61/14, të datës 09.12.2014, ka akuzuar të pandehurin Q. Q., për vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar në të cilin i pandehuri Q. Q. duke qenë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësit e pranimi të fajësisë, vullnetarisht pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Me tutje ka shprehur keqardhje për veprimin që e ka ndërmarë, ndërsa nga ajo kohë e deri më tani theksoi se nuk ka përsëritur vepër penale qoftë me armë apo diçka tjetër dhe, premtoi që edhe në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër të tillë apo të ngjashme, kërkoi falje nga gjykata për shkak se nuk ka ardhur me ftesë të parë të gjykatës, dhe arsyerja ka qenë se nuk ka pasë para me pagu biletën për të ardhur në Prishtinë.

Pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri, edhe prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e pranimi të fajësisë dhe se pranimi nga i njëjti është bërë në përputhje me provat e bashkangjitura në aktakuzë.

Pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe vullnetarisht ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimi të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri Q. Q., për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, meqë në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, gjykata, pasi më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë matjes dhe përcaktimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur, gjendjen sociale në familje, gjendjen shumë të dobët materiale, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim të kushtëzuar si dhe dënim plotësues, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të

KPRK dhe se i njëjti, në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Lidhur me shpenzimet, gjykata në zbatim të nenit 453 par. 4 të KPP, të pandehurin e liroi në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale, meqë vlerësoi se kushtet e tanishme ekonomike në të cilat i pandehuri jeton, obligimi për pagimin shpenzimeve të procedurës penale, do të rrezikonte gjendjen materiale të t'pandehurit ose personave që ai detyrohet t'i mbështes, meqë i pandehuri është i papunë përveç rasteve kur angazhohet përkohësisht në periudha të shkurtëra kohore, është mbajtësi i vetëm i familjes dhe baba i gjashtë fëmijëve dhe, një gjendje e tillë mund të konkludohet lehtësisht nga pamja e tij e jashtme dhe qëndrimi tij, e poashtu edhe nga vet pamundësia e tij për të ardhur në gjykatë në seancën e mëparshme për shkak të mungesës së mjeteve financiare për udhëtim, për çka gjykata pati urdhëruar sjelljen me shoqërim nga policia.

Vendimi për konfiskimin e sendeve, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 62 të KPRK lidhur me nenin 374 par. 3 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.699/14, me datë 16.11.2016

Sekretarja juridike
Ardita Azemi

Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja
Suzana Çerkini

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.